



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 7 shkurt 2017

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS AVOKATI I POPULLIT

**përkitazi me monitorimin në pikat e kalimit të kufirit
në
Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë
Pika kufitare “Hani i Elezit”
Pika kufitare “Vërmicë”**

Për: Z. Skender Hyseni, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Shpend Maxhuni, drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës

Z. Shaban Gruda, drejtor
Departamenti për Kufi
MPB

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar pikat e kalimit të kufirit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, Pika kufitare “Hani i Elezit” dhe Pika kufitare “Vërmicë”.

Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit gjatë muajit nëntor 2016 ka vizituar pikat e lartpërmendura të kalimit kufitar. Grupi monitorues përbëhej nga një juristë dhe një psikologe.

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

1. Gjatë vizitës në këto pika të kalimit kufitar, MKPT ka hasur në bashkëpunim të plotë të zyrtarëve policorë të cilët ishin në detyrë gjatë vizitës.

Vizita në pikën e kalimit kufitar Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë

2. Gjatë vizitës është vizituar dhoma ku mbahen personat e ndaluar përkohësisht të cilët qëndrojnë aty jo më shumë se 6 orë dhe ky ndalim bëhet mbi bazën e ndonjë urdhërese nga gjykata apo prokuroria si dhe mbi bazën urdhër arresti ndërkombëtar. Këta persona mbahen në këtë dhomë vetëm derisa të merren nga aty nga njësia përkatëse e Policisë së Kosovës.
3. MKPT është njoftuar nga zyrtari kompetent policor se aeroporti nuk posedon zonë transiti. Gjatë vizitës në këtë pikë të kalimit kufitar MKPT ka vizituar edhe hapësirat (2 dhoma me nga 8 shtretër) ku akomodohen personat të cilëve u mohohet hyrja në territorin e Republikës së Kosovës për arsye të ndryshme. Këta persona duhet të kthehen në vendet nga kanë ardhur brenda 72 orëve. Nëse kjo nuk ndodhë brenda kësaj periudhe kohore, ata dërgohen në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.
4. Këto dhoma ofrojnë kushte të mira për akomodim, kanë pastërti të duhur, tualete dhe dushe në gjendje shumë të mirë, si dhe u ofrohet edhe qasja në internet përmes “WI-FI”, gjë që u mundëson edhe kontaktet me familjet e tyre apo personat tjerë. MKPT konsideron se këto dhoma plotësojnë standardet e përcaktuara nga Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës lidhur me kushtet e mbajtjes së personave të cilëve u refuzohet hyrja në territorin e shtetit të caktuar.
5. **Gjatë vizitës së MKPT nuk kishte persona të akomoduar në këto dhoma, si dhe në dhomën ku përkohësisht mbahen personat e ndaluar mbi bazën e vendimeve të gjykatave apo kërkesave të prokurorisë.**

Shërbimet mjekësore

6. Personeli i shërbimit mjekësor i aeroportit përbëhet nga 6 infermiere dhe 3 mjekë të përgjithshëm. Shërbimet mjekësore ofrohen 24 orë për personat e ndaluar dhe personelin e aeroportit. Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se kjo qendër mjekësore është pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, tre shtretër, barna dhe dy auto ambulanca me pajisje.

Pika e kalimit kufitar “Hani i Elezit”

7. Gjatë vizitës në këtë pikë të kalimit kufitar me Republikën e Maqedonisë, MKPT u njoftua se në këtu gjendet një dhomë e ndalimit të përkohshëm i cili nuk zgjat më shumë se 6 orë. Zakonisht ndalohen personat mbi bazën e flet arrestit të gjykatave dhe prokurorive vendore dhe sipas urdhër arrestit ndërkombëtarë.


8. **MKPT ka vërejtur se dhoma e ndalimit të përkohshëm në këtë pikë kufitare kishte hapësirë të mjaftueshme, dyshek dhe çarçaf të pastër, ngrohje, si dhe ventilim të duhur.** Sipas zyrtarëve kompetentë, në këtë pikë të kalimit kufitar, pas ndalimit policia kufitare menjëherë e njofton njësinë përkatëse të Policisë së Kosovës e cila e merr të ndaluarin dhe e dërgon në institucionin përkatës. Kjo njësi e njofton të ndaluarin me të drejtat e tij/saj dhe procedurat tjera.
9. **Lidhur me shërbimet mjekësore, MKPT u njoftua se nëse kjo gjë është e nevojshme këto shërbime kërkohen nga Qendra më e afërt e mjekësisë familjare.**
10. Nga dokumentacioni vërehet se në këtë pikë kufitare dosjet e të ndaluarve plotësohen me të dhëna dhe dokumente të bollshme lidhur me ndalimin, dorëzimin tek njësia përkatëse e Policisë së Kosovës dhe arsyet e ndalimit. **Gjatë vizitës së MKPT nuk pati persona të ndaluar dhe as të akomoduar në dhomën për ndalim të përkohshëm.**

Pika e kalimit kufitar “Vërmicë”

11. Gjatë vizitës në këtë pikë të kalimit kufitar me Republikën e Shqipërisë, MKPT u njoftua se kjo pikë e kalimit kufitar posedon dy dhoma të ndalimit të përkohshëm (6 orë), si dhe një dhomë të intervistimit. Policia kufitare kishte formularë të gatshëm në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze përmes së cilave të ndaluarit njoftohen me të drejtat e tyre. Ndërsa lidhur me të drejtën për avokat, ai sigurohet nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe zakonisht janë avokatë nga Prizreni. Sipas zyrtarëve të kësaj pike të kalimit kufitar, Policia Kufitare posedon një listë të përkthyesve në gjuhët Evropiane dhe atë arabe.
12. **Dhomat e ndalimit të përkohshëm ishin në gjendje të mirë sa i përket hapësirës, pastërtisë, posedonin dyshek dhe çarçafë të pastër, si dhe ngrohje në nivel të kënaqshëm.**
13. Shërbimet mjekësore ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Prizren. **Në dosjet e të ndaluarve kishte të dhëna të plota lidhur me ndalimin e tyre dhe dorëzimin tek njësia përkatëse e Policisë së Kosovës.**

Pas vizitës në këto pika të kalimit kufitar, MKPT konstaton se ato i plotësojnë standardet për mbajtjen e përkohshme të personave të cilët ndalohen për arsye të ndryshme.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokati i Popullit